



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 24 të Ligjit Nr. 02/L-52 mbi edukimin parashkollor të datës 19.01.2006 , Udhëzimit Administrativ nr. 41/2007 - Zbritja e tarifave që duhet të paguhet nga prindërit për më shumë se një fëmijë në institucionet parashkollore dhe nenit 20 par 20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 28.09.2022, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

VENDIM

MBI CAKTIMIN E TARIFAVE PËR QËNDRIMIN DITOR TË FËMIJËVE NË INSTITUCIONET PARASHKOLLORE NË FSHATRA GADIME DHE SLOVI

Neni 1

Qëllimi

Me këtë Vendim përcaktohen obligimet e prindërve për pagesën e tarifave, procedura për lirim nga pagesa e këtyre tarifave , zvogëlimet e tarifave dhe aplikimi i tarifave për qëndrim ditor të fëmijëve në dy Institucionet parashkollore njëra në fshatin Sllavi dhe tjetra në fshatin Gadime .

Neni 2

Kompenzimi për qëndrim ditor

Prindërit, përkatësisht kujdestarët, për vendosjen e fëmijëve për qëndrim ditor në Institucionet parashkollore në Gadime dhe Sllavi, në emër të participimit për një fëmijë, për çdo muaj duhet të paguajnë shumën prej 30.00 €.

Neni 3
Lirimi nga pagesa e tarifave

Lirimi nga pagesat e përcaktuara në nenin 1 të këtij Vendimi do të bëhet në pajtim me dispozitat ligjore .

Neni 4
Zvogëlimi i tarifave

Prindërit përkatësisht kujdestaret e fëmijëve do te paguajnë tarifën e zvogëluar për qëndrimin ditor për më shumë se një fëmijë, s'i vijon:

Për fëmijën e dytë shumën prej 21.00 €.

Për fëmijën e tretë shumën prej 15.00 €.

Neni 5
Aplikimi i Tarifave

Aplikimi i tarifave do të fillojë pas përfundimit të fazës provuese pasi dy institucionet parashkollore të cekura më lartë janë në fazën provuese të funksionalizimit të tyre përkatësisht fillojnë të aplikohen nga data 01.01.2023 dhe vlejné deri me datën 31.12.2023 .

Neni 6
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit lokal dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen e Komunës.

Nr. 15-610/07-52751

Lipjan, më 28.09.2022

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit
Daut Azemi

